



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:070134

Datë: 29.09.2020

Numri i dokumentit: 01146424

## NË EMËR TË POPULLIT

**GYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**, sipas gjyqtarit Ibrahim Idrizi - kryetar i trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Qëndresa Bobi - Neziri, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.D për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 par. 1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzes së Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda , PP/L.nr. 93/20 të datës 03.07.2020, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me 22.09.2020 në prani të prokurorit te shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Naim Ferati, shpalli dhe publikisht komunikoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **J.D**, i biri i K... dhe nënës H... e gjinisë C..., i lindur me ... në Gjilan ku edhe jeton në adresë rruga “ ...” numër ..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, pa pune, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i dy fëmijëve, me numër personal ..., me gjendje të dobët ekonomike, mbrohet në liri.

### Ë s h t ë f a j t o r

Nga data e pa përcaktuar deri me datë 26.05.2020, në shtëpinë e tij në Han të Elezit i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët në Kosovë, ka poseduar revolën e markës “Zastava” kalibër 7.65 mm, me ngjyrë të zezë, me numër serik ... dhe një karikator të zbrasët të cilat me rastin e një kontrolli nga ana e Policisë së Kosovës i gjenden dhe sekuestrohen,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69 dhe 366 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së,

## **E g j y k o n**

Me dënim gjobe në shumë prej 500 euro.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format e parapara në nenin 43 të KPRK-së, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ do ti llogaritet një ditë burgimi.

I akuzuari lirohet nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe nga pagesa në Fondiin e Kompensimin e Viktimave të Krimet.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme revolën e markës “Zastava” kalibër 7.65 mm, me ngjyrë të zezë, me numër serik ... dhe një karikator të zbrazët dhe pasi aktgjykimi të merr formën e prerë arma e konfiskuar të shkatërrohet – asgjësohet.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën , PP/L.nr. 93/20 të datës 03.07.2020 , të akuzuarin J.D e ka akuzuar për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, - Departamenti Për Krime Të Rënda, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 22.09.2020, ka dorëzuar në Gjykatë, marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur në mes të prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij, në të cilën i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit dhe ka arritur marrëveshje që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim gjobe .

Kryetari i trupit gjykues në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 22.09.2020 vlerësoi marrëveshjen për pranimin e fajsisë, konstatoi se i akuzuari fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet e ka pranuar në mënyrë vullnetare, ka qenë i vetëdijshëm dhe ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare, është konsultuar mjaftushëm me mbrojtësin e tij me autorizim, pranimi i fajsisë mbështetet në të gjitha provat dhe faktet që janë të prezantuara në aktauzë, nuk ekziston asnjëra nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.1 të KPPK-së, për hudhjen e aktakuzës. I akuzuari ka qenë i njoftuar lidhur me dënimin për këtë veprë penale, para se të nënshkruaj marrëveshjen është njoftuar lidhur me pasojat që rrjedhin nga nënshkrimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, që i referohen tërheqjes nga e drejta për gjykim me shqyrtim të provave si dhe të pamundësisë për të paraqitur ankesë, lidhur me sanksionin penal.

Kryetari i trupit gjykues duke vlerësuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, të gjitha provat e çështjes dhe pasi që konstatoi se është aplikuar dispozitat e nenit 233 të KPPK-së, gjatë negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në nenin 233 par.18 të KPPK-së, andaj e pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të arritur dhe të nënshkruar nga palët në procedurë, e që do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të kësaj qëshjte penale, poashtu trupi gjykues konstatoi se i akuzuari është penalisht përgjegjës për këtë veprë penale, e shpalli fajtorë duke i vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 350 euro, të cekur si në dispozitivë të aktgjykimit.

Gjykata gjatë caktimit të këtij dënimi pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e dënimit që i referohen personalitetit të të akuzuarit – pranimin të fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, nuk është i njohur si kryes i veprave penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPPK-së, duke ndikuar që i akuzuari në të ardhmen mos të kryej vepra penale poashtu duke i shërbyer edhe preventivës gjeneralë në atë mënyrë që personat e tjerë t'i parandalojë që të mos kryejnë vepra të tilla penale.

Në bazë të nenit 453 par. 4 të KPPK-së, i akuzuari u lirua nga shpenzimet paushalle dhe shpenzimet për kompensimin e Viktimave të Krimit, sepse pagesa e këtyre shpenzimeve do ta vështirësonte gjendjen materiale të të akuzuarit dhe personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht, kjo për faktin se familja e tij është shfrytëzues i ndihmes sociale.

Vendimi mbi konfiskimin është i bazuar në nenin 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga te cekurat me lart u vendos si në dispozitivë të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

**PKR.101/20**

Më 22 shtator 2020

Sekretare Juridike,

Kryetari i trupit gjykues- gjyqtari,

Qëndresa Bobi - Neziri

**Ibrahim Idrizi**

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palet ne procedurë nuk kanë të drejtë ankesë.